

## Biturku:Luajtem nje ndeshje me dy fytyra

nga Albaniassocer

E enjte, 13 Mars 2014 20:06

---



Ndeshjen e sotme e luajtem me dy fytyra.Ne pjesen e pare nuk luajtem mire edhe per merite te Tiranes kurse te dyten patem raste dhe mund te shenonim e teper dhe te fitonim.Nuk zevendesova Kalune se po luante keq por per te patur nje lojtar me teper sulmues ne fushe.Besoj se goli i Tirane ishte eurogol i Karabecit he nuk pashe gabime na ana jone.Mungesat ndihen sepse prishen ekuilibrat por ne kemi nje ekip shume te mire dhe jane njelloj ska rezerva dhe titullare.Kryesorja ishte qe nuk u goditem ne fund te ndeshjes sepse eshte goditje psikologjike ta pesosh ne fund dhe nuk ke kohe te reagosh.Ne ne Vlore do shkojme per fitore dhe uroj qe te fitojne me i forti meqe edhe ato jane ne nje perjudhe jo shume te mire siq edhe ne.Mendoj se Dosti me kualitetet qe ka teknikisht eshte ne gjendje te kalojne kundrshtaret dhe prandaj e vendosem ne krahun e majte por nuk ishte fiks aty,kishte detyre te paraqitej nga krahu i majte.